



Republika e Kosovës
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës Hani i Elezit
Municipality Assambly of Hani Elezit

01/ Nr.148/2011

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 neni 17, 40, Ligjit për Planifikim Hapësinor Nr.2003/14 neni 16, Statutin e Komunës së Hanit të Elezit neni 76, Rregulloren e punës së Kuvendit të Komunës neni 15, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 27.12.2011 merr këtë:

VENDIM

PËR

HARTIMIN E PLANIT RREGULLUES URBAN PËR QENDRËN DHE LAGJEN E PARKUT NË HAN TË ELEZIT

I

Me këtë vendim fillohet Hartimi i Planit Rregullues Urban për Qendrën dhe Lagjen e Parkut në Han të Elezit.

II

Sipërfaqja e përkufizuar në këtë Plan përfshinë dy Njësi Urbane nga gjithsej gjashtë sosh që e përbëjnë Zonën Urbane të Hanit të Elezit. Këto Njësi janë Qendra dhe Lagja e Parkut. Sipërfaqja në fjalë përfshinë pjesën veriore të Zonës Urbane dhe fillon nga "Dheu i Bardhë" në veri (në trekëndëshin e Zonave Kadastrale të Hanit të Elezit, Pustenic dhe Paldenicë) duke ndjekur në lindje kufirin mes dy Zonave Kadastrale (Hani i Elezit dhe Paldenicë) deri në pikën tjetër trekëndëshe të Zonave Kadastrale (Hani i Elezit, Paldenicë dhe Neçavc). Nga aty kthehet në jug duke përfshirë sipërfaqen veriore të ish ushtrisë dhe Lagjen Vila. Kufiri bën kthesë të serishme në lindje kur takon parcelën lindore të ish ushtrisë (sipërfaqe e planifikuar si Park i Qytetit me PZHU). Ky kufi përfshikon rreth e rrotull këtë parcelë dhe në kthim për te magjistralja Prishtinë-Shkup e përfshinë edhe sipërfaqen e banuar ngjitur me njësinë tjetër Urbane Industrinë (mihja sipërfaqësore-Ilapori). Nën magjistrale vazhdon nëpër të njëjtin kufi me Industrinë (kufiri mes Qendrës dhe Sharrcem-it) deri te hekurudha. Nga aty vazhdon për vijën hekurudhore në veri deri sa të arrijn pikën fillestare të "Dheu i Bardhë". Kufiri i këtyre dy njësive urbane u përshkrua hollësisht për arsye të qartësimit të asaj se çka përfshihet në këto sipërfaqe. Kjo do të ilustruhet edhe me hartën e bashkangjitur. Për më shumë hollësi, të gjitha njësitë Urbane me kufijtë e tyre janë të paraqitura detalisht në planin zhvillimorë Urbanë i cila u aprovua në Shtator 2011.

III

Sipërfaqja që do të përfshijë plani ka 46 hektarë nga gjithsej 159.88 hektarë sa përfshinë Zona Urbane

IV

Me Planin nga neni 1 i këtij vendimi do të planifikohet zgjidhja dhe rregullimi i hapësirës si dhe harmonizimi i kësaj të fundit me nevojat reale dhe mundësinë për të arritur kushte sa më optimale zhvillimore dhe organizative hapësinore, të rregullimit dhe të ndërtimit të Zonës Urbane të Hanit të Elezit me qëllim për të arritur një qasje të integruar e cila përfshinë zhvillimin ekonomik, shoqëror, politikat mjedisore, elementet hapësinore të transportit si dhe politikat tjera për hapësirën urbane.

V

Ky Plan do të hartohet duke u bazuar në Planin Zhvillimor Komunal dhe Planin Zhvillimor Urban të Hanit të Elezit të aprovuar në Shtator 2011.

VI

Bartës i hartimit të këtij Plani është Komuna e Hanit të Elezit respektivisht Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik; me asistencën teknike të UN HABITAT-it, në kuadër të Memorandumit të Mirëkuptimit (faza e 3-të e Programit për Mbështetjen e Planifikimit Hapësinor Komunal – MuSPP) të nënshkruar në mes të Komunës së Hanit të Elezit dhe UN HABITAT-it.

VII

Bartësi i hartimit të këtij Plani sipas nenit 1 të këtij vendimi është i obliguar që Planin ta hartojë në afat prej 24 muajve që nga dita e hyrjes në fuqi të këtij vendimi

VIII

Projekti i Planit duhet të vëhet në shqyrtim publik dhe komente. Paraqitja e Planit në shqyrtim publik dhe koha për dhënien e shqyrtimeve dhe komenteve do të shpallen në mjetet e informimit.

IX

Plani hartohet për periudhën kohore më së paku 5 vjeçare dhe elaborati i Planit sipas nenit 1 të këtij vendimi do të hartohet në 7 kopje të origjinalit.

X

Ky vendim hynë në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës.

XI

Me këtë vendim njoftohen: Drejtoria për Urbanizëm Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtoria e Politikave Strategjike dhe Zhvillimit Ekonomik, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Shërbimi i Arkivit.

Hani i Elezit
Data: 30.12.2011

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Menduh Vlashi

